



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 2570 Prot.

Laç, me 02.05.2019

**V E N D I M - S H P A L L J E**

**(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit te Ekzekutimit" te titullit ekzekutiv te debitorit)**

Ne Lac, sot me date 02.05.2019

Une, Mikeda Cenaj, me detyre Permbarues Gjyqesore prane Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale te çeshtjes permbarimore Nr.4567 rregj. te vitit 2019 bazuar ne "Urdherin e ekzekutimit" nr. 2269-(1399) te dates 21.12.2018 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Korce.

**KONSTATOVA**

Se ne daten 12.04.2019 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit kerkesa e kreditorit se bashku me urdherin e ekzekutimit te leshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv (procesverbal i konstatimit te kundravajtjes) nr.004370 me dt.22.11.2018 i leshuar nga Drejtoria Rajonale per Kufirin dhe Migracionin me pale dhe objekt:

- Kreditor : D.R.K.M KORCE .
- Debitor: Klaudio Hamid Tafa i dtj. 23.10.1988 me banim ne Koçekeve 046,Lac .
- Me objekt: Pagim gjobe administrative ne vleren 10.000 leke + T.F.Permbarimore.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor"i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitori Klaudio Hamid Tafa nuk merr dijani nepermjet sherbimit postar dhe si rezultat I kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile duhet te behet njoftimi me shpallje publike I debitorit lidhur me detyrimin qe ai ka ndaj pales kreditore D.R.K.M KORCE per gjoben administrative dhe tarifat fikse permbarimore ne masen 10000 leke.

Sa me siper ne mbeshtetje te Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor",i ndryshuar

**V E N D O S A**

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njezet) ditore (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 02/05/2019 - 21/05/2019 te debitorit Klaudio Hamid Tafa i dtj. 23.10.1988 me banim ne Koçekeve 046,Lac .

2-Ky vendim perpilohet ne disa kopje,ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore,nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Bashkise Kurbin,nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje i dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vleren e aktit te njoftimit per palen debitore Klaudio Hamid Tafa i dtj. 23.10.1988 me banim ne Koçekeve 046,Lac.

4-Pala debitore Klaudio Hamid Tafa i dtj. 23.10.1988 me banim ne Koçekeve 046,Lac,duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4,Lac ne katin e pare ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te marre kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'iu vene ne dispozicion aktet permbarimore pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile.

U shpall,sot me date 02.05.2019.

PERMBARUES GJYQESOR  
MIKEDA CENAJ

